



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:243357

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05440563

P.nr.1204/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me praktikantin Erzen Kelmendi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh.Sh., nga Prizreni, për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 06/L-074 (KPRK)-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.1247-8/21 të datës 25.10.2021 të Prokurorisë Themelore në Prizren, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e prokurorit të shtetit Musli Gashi, të akuzuarit Sh.Sh., dhe mbrojtësit të tij av.Arben Shala nga Prizreni, më datë **29.02.2024**, publikisht mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

SH.SH., nga i ati, e ëma, e lindur, i lindur me datë, nga Prizreni, me vendbanim në Rr “.....”Prizren, ka të kryer shkollën e mesme, i divorcuar, punëtorë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Më datë 14.03.2021, rreth orës 04:00 të mëngjesit, në Prizren, në rrugën “Zahir Pajaziti”, i pandehuri me qëllim të dëmtimit të pasurisë së të dëmtuarit E.G., në atë mënyrë që shfrytëzon orët e hershme të mëngjesit, derisa i dëmtuari ishte në gjumë, merr disa tulla të betonit nga podrumi i ndërtesës ku banonte i dëmtuari dhe vetë i pandehuri, ku fillimisht e gjuan në xhamin e dritares së dhomës së fjetjes ku ishte duke fjetur i dëmtuari ku e thyen roletën dhe xhamin e dritares, e më pas e gjuan në veturën e të dëmtuarit dhe ja thyen xhamin e përparme dhe pjesën e tavanit të veturës të markës “.....”, me targa, pronë e të dëmtuarit dhe më pas largohet nga aty dhe ngjitet lart në banesën e tij që ishte në të njëjtin objekt, me të cilat veprime të dëmtuarit i shkakton dëm material.

Këso dore ka kryer veprën penale: Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 7, 17, 38,39, par 1 nën par 1.1, 40 par 1 nën par 1.3,43, 69 dhe 70, nenit 321 par 1 të KPK-së dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK),

Të akuzuarin **SH.SH.**, :

GJYKON

Për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të akuzuarit i shqipton **dënim me gjobë në shumë prej 250 € (dyqind e pesëdhjetë) euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar të paguaj në afat kohor prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzet) euro llogaritet 1 (një) ditë burgim

I Dëmtuari EG., nga Prizreni Rr “..... “ nr, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

I akuzuari **OBLIGOHET** që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, dhe në emër të kompensimit të viktimave, të paguaj shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1247-8/21 të datës 25.10.2021 ndaj të akuzuarit Sh.Sh., nga Prizreni, Rr “ “ nr..... Prizren, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të Kodit nr. 06/L-074 (KPRK)-së.

Pas pranimit të shkresave të lëndës gjyqtari i vetëm gjykuese, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 29.02.2024, në të cilin shqyrtim, të akuzuarit Sh.Sh., pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat u takojnë, sipas ligjit, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e ka pranuar fajësinë që iu ngarkohet me aktakuzë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar **Prokurori i shtetit Musi Gashi deklaroi** nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, me pranimin e fajësisë në tërësi vërtetohet gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës me këtë edhe fakti se i pandehuri Sh.Sh., ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par 1 të KPRK-së nr. 06/L-074. Pranimi i fajësisë nga ana e gjykatës të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, dhe se gjykata të i merr parasysh të gjitha rrethanat ashtu që të pandehurit të i shqiptoj një dënim meritohet.

Mbrojtësi i të pandehurit Sh.Sh., – **avokat A.Sh., deklaroi** pas gjitha atyre konsultave me të mbrojturin e tij pa shtytje, pa presion ku i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare duke pasur parasysh edhe arsyet ligjore si edhe rrethanë lehtësuese me vullnetin e tij të plotë edhe e pranon fajësinë. Andaj i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, është hera e parë dhe e pa qëllim dhe të merret një dënim sa më i butë.

I akuzuari Sh.Sh., ka deklaruar se e pranon fajësinë vullnetarisht për veprën penale për të cilën është i ngarkuar si në aktakuzë duke theksuar se është penduar për një veprim të tillë, ka gabuar për këtë veprim, shpreh kërkim falje ndaj të dëmtuarit, kjo ka ndodhur nga momenti i çastit dhe në mënyrë të pa qëllim, me të dëmtuarin kurrë më parë nuk kan pasur probleme as që e ka njohur më parë, është hera e parë që ka rënë ndesh me Ligjin, është i pa punë, është hera e parë dhe e pa qëllim që e ka bërë një veprim të tillë, premtion dhe zotohet se në të ardhmen më kurrë nuk do të përsëritë një veprim të tillë, e lut gjykatën që deklarata e tij të mirret si rrethanë lehtësuese në shqiptim të dënimit sa më të but.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pranimin e fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat të cilat i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose faktike .

Gjyqtari i vetëm gjykuese në shqyrtimin fillestar pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit i ka njoftuar palët mbi seancën mbi dënimin konform nenit 356 të KPPRK-së, të njëjtit kanë deklaruar se hjekin dorë nga seanca e veçantë mbi dënimin, kështu që gjykata ka proceduar me shpalljen e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Më datë 14.03.2021, rreth orës 04:00 të mëngjesit, në Prizren, në rrugën “.....”, i pandehuri me qëllim të dëmtimit të pasurisë së të dëmtuarit E.G., në atë mënyrë që shfrytëzon orët e hershme të mëngjesit, derisa i dëmtuari ishte në gjumë, merr disa tulla të betonit nga podrumi i ndërtesës ku banonte i dëmtuari dhe vetë i pandehuri, ku fillimisht e gjuan në xhamin e dritares së dhomës së fjetjes ku ishte duke fjetur i dëmtuari ku e thyen roletën dhe xhamin e dritares, e më pas e gjuan në veturën e të dëmtuarit dhe ja thyen xhamin e përparme dhe pjesën e tavanit të veturës të markës “Ford Fokus”, me targa 04-499FN pronë e të dëmtuarit dhe më pas largohet nga aty dhe gnjitet lart në banesën e tij qe ishte në të njëjtin objekt, me të cilat veprime të dëmtuarit i shkakton dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata komform nenit 251 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas ligjit.

Kështu, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së dhe faktet që përmban aktakuza, dhe se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale asgjësim apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par 1 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovës, për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese për të akuzuarin Sh.Sh., gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, kërkim faljen, pendimin dhe keqardhjen . Ndërsa, si rrethanë rënduese gjykata ka marrë mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, se i akuzuari ka kryer vepër penale kundër pasurisë. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitive të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla të kundërligjshme dhe se ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari.

Vendimi mbi për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 462 par.1 e 2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale u mor në kuptim të nenit 449 dhe 452 par. 1. të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të Ligjit nr.08/L-109.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitive të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2021:243357, 29.02.2024

**Praktikanti
Erzen Kelmendi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Gani Kastrati**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.